



**KËSHILLI KOORDINUES
I DIASPORËS**

**Mbledhja e parë e
Këshillit Koordinues
të Diasporës**

Tiranë, 18 Dhjetor 2019

Përmbajtja

VENDIM Nr. 1, datë 18.12.2019 PËR “MIRATIMIN E RREGULLORES SË FUNKSIONIMIT TË KËSHILLIT KOORDINUES TË DIASPORËS”	2
RREGULLORJA E FUNKSIONIMIT TË KËSHILLIT KOORDINUES TË DIASPORËS	3
VENDIM Nr. 2, datë 18.12.2019 PËR “ZGJEDHJEN E KRYETARIT, NËNKRYETARIT DHE SEKRETARIT TË KËSHILLIT KOORDINUES TË DIASPORËS”	10
VENDIM Nr. 3, datë 18.12.2019 PËR “NGRITJEN E GRUPIT TË PUNËS PËR ORGANIZIMIN E KUVENDIT TË III-TË TË DIASPORËS”	11



Më 18 dhjetor, në Ditën Kombëtare të Diasporës, Këshilli Koordinues i Diasporës zhvilloi mbledhjen e parë me përfaqësuesit më të lartë të institucioneve shtetërore. Këshilli është një strukturë e re, e krijuar për herë të parë në historinë e shtetit shqiptar, dhe funksionimi i tij mbështetet në Ligjin Nr. 16/2018 “Për Diasporën”. Misioni i Këshillit është përfaqësimi i interesave të shqiptarëve të larguar nga vendlindja dhe forcimi i marrëdhënieve të tyre me Shqipërinë.

Këshilli ka në përbërjen e tij: tre përfaqësues nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, gjashtë përfaqësues nga Bashkimi Evropian, dy përfaqësues nga Britania e Madhe, dy përfaqësues nga Kanadaja, një përfaqësues nga Turqia dhe një përfaqësues nga Australia.

Këshilli Koordinues i Diasporës është i pavarur nga interesat politike. Ai synon të krijojë ura lidhëse me vendin amë dhe të kontribuojë në konsolidimin e një Diaspore të vetëdijshme për misionin e saj atdhetar, të ruajë, të kultivojë dhe të përhapë gjuhën, kulturën dhe traditat më të mira shqiptare, të mbështesë dhe të orientojë potencialet intelektuale të Diasporës në shërbim të zhvillimit shoqëror, politik dhe ekonomik të kombit, të jetë zëri i së vërtetës në shërbim të interesave të popullit dhe çështjeve kombëtare.

Ky dokument është një përmbledhje informuese për vendimet e miratuara gjatë mbledhjes së parë të Këshilli Koordinues të Diasporës.

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOORDINUES I DIASPORËS**

Nr. 599 Prot.

Tiranë, më 18.12.2019

VENDIM

Nr. 1, datë 18.12.2019

PËR

**“MIRATIMIN E RREGULLORES SË FUNKSIONIMIT
TË KËSHILLIT KOORDINUES TË DIASPORËS”**

Në mbështetje të nenit 18, pika 2 dhe nenit 21 të Ligjit Nr. 16/2018 “Për diasporën”, të vendimit Nr.340, datë 06.06.2018 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për kushtet dhe mënyrën e zgjedhjes së përfaqësuesve të Këshillit Koordinues të Diasporës”, Vendimit Nr. 195, datë 05. 04. 2019 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e anëtarëve të Këshillit Koordinues të Diasporës” dhe Vendimit Nr.320, datë 15.05.2019 të Këshillit të Ministrave “Për statusin e anëtarëve të Këshillit Koordinues të Diasporës”, Këshilli Koordinues i Diasporës,

VENDOSI:

1. Miratimin e Rregullores së funksionimit të Këshillit Koordinues të Diasporës, sipas tekstit bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



KËSHILLI KOORDINUES
I DIASPORËS

RREGULLORJA E FUNKSIONIMIT TË KËSHILLIT KOORDINUES TË DIASPORËS

Këshilli Koordinues i Diasporës (KKD) është krijuar me Ligjin nr.16, datë 05.04.2018, “*Për Diasporën*”. Rregullorja e Funkcionimit të Brendshëm miratohet nga Këshilli Koordinues i Diasporës, në zbatim të nenit 18, pika 2/b, të këtij ligji, “... miraton rregullat procedurale për përmbushjen e veprimtarisë së tij dhe procedurën e vendimmarrjes”.

Neni 1 Qëllimi i rregullores

Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e rregullave për:

- a) Funkcionimin e brendshëm të Këshillit Koordinues të Diasporës Shqiptare;
- b) Të drejtat dhe detyrimet për Anëtarët e Këshillit Koordinues të Diasporës në lidhje me përmbushjen e detyrave të caktuara sipas kuadrit ligjor të Republikës së Shqipërisë;
- c) Mënyrën e administrimit të vendimmarrjes dhe dokumenteve të krijuara apo të ardhura në adresë të Këshillit Koordinues të Diasporës Shqiptare;
- ç) Instrumentet ligjore dhe teknike për zhvillimin e duhur të veprimtarisë administrative dhe teknike të Këshillit.

Neni 2 Baza ligjore

1. Rregullorja e brendshme e Këshillit Koordinues të Diasporës Shqiptare funksionon në bazë të legjislationit të Republikës së Shqipërisë. Si e tillë, ajo është hartuar në zbatim të Ligjit nr. 16, datë 05.04.2018, “*Për Diasporën*”.
2. Rregullorja e funksionimit të Këshillit Koordinues të Diasporës është në kohezion të plotë me Vendimin nr. 320, datë 15.05.2019, “*Për statusin e anëtarëve të Këshillit Koordinues të Diasporës*”.

Neni 3 Funksionimi

1. Këshilli Koordinues i Diasporës Shqiptare përbëhet nga 15 anëtarë. Zgjedhja e tyre realizohet në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 340/2018, “*Për caktimin e rregullave të hollësishme për kushtet dhe mënyrën e zgjedhjes së përfaqësuesve të Këshillit Koordinues të Diasporës*”.
2. Në aktivitetet zyrtare të Këshillit Koordinues të Diasporës marrin pjesë Kryeministri, ministri përgjegjës për diasporën, ministri përgjegjës për punët e jashtme, ministri përgjegjës për punët e brendshme, ministri përgjegjës për financat dhe ekonominë , ministri përgjegjës për arsimin, ministri përgjegjës për kulturën, përfaqësues nga Akademia e Shkencave, nga Dhoma Kombëtare e Tregtisëdhe Industrisë, nga Radiotelevizioni Shqiptar, nga Agjencia Kombëtare e Diasporës,



**KËSHILLI KOORDINUES
I DIASPORËS**

nga Qendrat Kulturore të Diasporës, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për diasporën në qeverinë e Kosovës, si dhe nëse Këshilli Koordinues i Diasporës e çmon të nevojshme fton në aktivitetet zyrtare të tij edhe organizata të diasporës.

3. Presidenti i Republikës, me kërkesën e tij dhe në koordinim me Kryeministrin dhe ministrin përgjegjës për Diasporën, merr drejtimin e mbledhjeve të veçanta të Këshillit Koordinues të Diasporës.

Neni 4 Kompetencat

1. Këshilli Koordinues i Diasporës ka këto kompetenca:

- a) identifikon problemet e Diasporës dhe i propozon ministrit përgjegjës për Diasporën veprime për zgjidhjen e tyre;
- b) kërkon informacion mbi koordinimin ndërmjet ministrit përgjegjës për Diasporën në Shqipëri dhe ministrisë përgjegjëse për Diasporën në Kosovë mbi veprimet e ndërmarra lidhur me problemet e identifikuar nga KKD-ja
- c) përcakton linja orientuese për hartimin/ndryshimin e strategjisë për Diasporën;
- ç) miraton rregulla procedurale për përmbushjen e veprimtarisë së tij dhe vendimmarrjen;
- d) ndërton marrëdhëniet e bashkëpunimit midis palëve;
- dh) ndihmon dhe koordinon aktivitetin e shoqatave në Diasporë;
- e) ndërmerr nisma në shërbim të kombit dhe demokracisë.

2. Aspektet financiare për zhvillimin e veprimtarisë së Këshillit Koordinues të Diasporës ushtrohen nga Agjencia Kombëtare e Diasporës.

Neni 5 Selia

Selia e Këshillit Koordinues të Diasporës Shqiptare është në Agjencinë Kombëtare të Diasporës në Tiranë.

Neni 6 Struktura organizative

1. Struktura organizative e Këshillit Koordinues të Diasporës miratohet me këtë Rregullore të Këshillit Koordinues të Diasporës Shqiptare.



**KËSHILLI KOORDINUES
I DIASPORËS**

2. Struktura organizative e Këshillit Koordinues të Diasporës Shqiptare përbëhet nga kryetari, nënkryetari dhe sekretari, të cilët zgjidhen nga anëtarët e këtij Këshilli.
3. Zgjedhja e strukturës organizative bëhet me short, sipas një sistemi pikësh. Çdo anëtar voton për tre anëtarë të tjerë, duke i dhënë secilit prej tyre tre, dy dhe një pikë. Anëtarë që mbledh më shumë pikë është kryetari, i dyti nënkryetari dhe i treti sekretari.
4. Zgjedhja e kryetarit, nënkryetarit dhe sekretarit bëhet me votim të fshehtë.

**Neni 7
Mandati**

1. Përfaqësuesit e Këshillit Koordinues të Diasporës zgjidhen për një periudhë 4-vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.
2. Anëtarë i Këshillit Koordinues të Diasporës lirohet para mbarimit të mandatit 4-vjeçar, në rastet kur:
 - a) jep dorëheqjen me kërkesë individuale;
 - b) ushtron veprimtarinë në kushtet e konfliktit të interesit;
 - c) për shkaqe të tjera.
3. Anëtarë i Këshillit Koordinues të Diasporës shkarkohet para mbarimit të mandatit 4-vjeçar, në rastet kur:
 - a) neglizhon kryerjen e detyrave;
 - b) nuk përmbush funksionet e parashikuara nga ligji nr. 16/2018, "Për Diasporën", si dhe nga Vendimi nr. 320, datë 15.05.2109 i Këshillit të Ministrave "Për statusin e anëtarëve të Këshillit Koordinues të Diasporës";
 - c) nuk merr pjesë, pa arsye, në mbledhje për më shumë se 2 herë radhazi;
 - ç) bëhet i paaftë për të kryer funksionet e ngarkuara për shkak të sëmundjeve fizike ose mendore për një periudhë më të gjatë se 6 muaj;
 - d) gjatë ushtrimit të funksioneve të tij, vepron në kundërshtim me interesat e Këshillit Koordinues të Diasporës.

**Neni 8
Kryetari, nënkryetari dhe sekretari**

1. Kryetari i Këshillit Koordinues të Diasporës përfaqëson Këshillin Koordinues të Diasporës në marrëdhënie me të tretët dhe jep deklarata në emër të tij. Ai është zëdhënës i vendimmarrjes kolektive të Këshillit sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje.



**KËSHILLI KOORDINUES
I DIASPORËS**

2. Kryetari i Këshillit Koordinues të Diasporës ka këto detyra, por pa u kufizuar në to:
- a) Drejton mbledhjen e Këshillit Koordinues të Diasporës, duke përçuar dhe garantuar zbatimin e parimeve, vlerave, ligjshmërisë dhe etikës në të;
 - b) Siguron rendin dhe rregullin gjatë mbledhjeve të Këshillit Koordinues të Diasporës, si dhe garanton që t'u jepet fjala të gjithë anëtarëve të Këshillit;
 - c) Bashkërendon organizimin e mbledhjeve zyrtare të Këshillit Koordinues të Diasporës në bashkëpunim me sekretarin dhe Agjencinë Kombëtare të Diasporës;
 - ç) Koordinon objektivat dhe detyrat e anëtarëve të Këshillit Koordinues të Diasporës vetëm në zbatim të vendimmarrjeve të këtij të fundit;
 - d) Mbikëqyr, së bashku me nënkryetarin, veprimtarinë e Agjencisë Kombëtare të Diasporës në funksion të ndjekjes së detyrave dhe vendimeve të Këshillit Koordinues të Diasporës.
 - dh) Së bashku me nënkryetarin, është i detyruar të informojë anëtarët e Këshillit Koordinues të Diasporës kur vepron si i tillë në marrëdhënie me palë të treta me të drejtat e përfaqësimit për çështje të ndryshme.

Neni 9

Mbledhja e Këshillit Koordinues të Diasporës

- 1. Mbledhja e Këshillit Koordinues të Diasporës zhvillohet, si rregull, në datën 18 dhjetor të çdo viti, në Ditën Kombëtare të Diasporës.
- 2. Këshilli Koordinues i Diasporës mund të mbledhet edhe me kërkesën e jo më pak se një të tretës së anëtarëve të tij ose me kërkesë të ministrit përgjegjës për Diasporën, me një program të përcaktuar paraprakisht.
- 3. Në bashkëpunim me ministrin përgjegjës për Diasporën, kryetari i Këshillit vendos vendin e mbledhjes së radhës.
- 4. Mbledhja e Këshillit Koordinues të Diasporës zhvillohet nën drejtimin e kryetarit të Këshillit Koordinues të Diasporës, përveç rasteve kur Presidenti i Republikës së Shqipërisë, me kërkesën e tij dhe në koordinim me Kryeministrin dhe ministrin përgjegjës për Diasporën, merr drejtimin e mbledhjeve të veçanta të Këshillit Koordinues të Diasporës, sipas pikës 2 dhe 3 të nenit 19, të Ligjit nr. 16, datë 05.04.2018 “Për Diasporën”.
- 5. Me njoftimin për organizimin e mbledhjes së Këshillit Koordinues të Diasporës, sekretariati teknik (Agjencia Kombëtare e Diasporës) i vë në dispozicion çdo anëtar materiallet sipas çështjeve që do të trajtohen në rendin e ditës.
- 6. Në rastet e mbledhjeve të Këshillit Koordinues të Diasporës jashtë radhës, njoftimi i çdo anëtar bëhet jo më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune përpara zhvillimit të mbledhjes, përveç rasteve kur çështjet janë me rëndësi në kohë dhe seanca e posaçme e mbledhjes së Këshillit Koordinues të Diasporës pranohet nga jo më pak se dy të tretat e anëtarëve.



**KËSHILLI KOORDINUES
I DIASPORËS**

7. Agjencia Kombëtare e Diasporës, si sekretariati teknik i Këshillit Koordinues të Diasporës, në bazë të projekteve dhe çështjeve të paraqitura për shqyrtim, përgatit rendin e ditës të mbledhjeve. Rendi i ditës dhe materialet u dërgohen anëtarëve të Këshillit Koordinues të Diasporës jo më pak se 30 (tridhjetë) ditë përpara datës së caktuar për zhvillimin e mbledhjes.
8. Në rastet e mbledhjeve të jashtëzakonshme, në bazë të projekteve dhe çështjeve të paraqitura për shqyrtim, sekretariati teknik përgatit rendin e ditës, i cili u dërgohet anëtarëve të Këshillit Koordinues të Diasporës jo më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike përpara datës së caktuar për zhvillimin e mbledhjes.
9. Mbledhjet e Këshillit Koordinues të Diasporës janë të vlefshme kur në të marrin pjesë dy të tretat e anëtarëve të tij. Këshilli Koordinues i Diasporës vendos me dy të tretat e votave të të gjithë anëtarëve të tij. Votimi për vendimmarrjet e Këshillit Koordinues të Diasporës bëhet i hapur.
10. Procesverbalet e Këshillit Koordinues të Diasporës mbahen nga Agjencia Kombëtare e Diasporës dhe verifikohen nga sekretari dhe kryetari i Këshillit Koordinues të Diasporës.
11. Agjencia Kombëtare e Diasporës përgatit brenda 5 (pesë) ditëve pune procesverbalin nga zhvillimi i mbledhjes dhe ua dërgon të gjithë anëtarëve të Këshillit me postë elektronike.

**Neni 10
Komunikimi elektronik**

1. Këshilli Koordinues i Diasporës ka faqen e tij zyrtare në internet: <http://keshilli.koordinues.diaspora.gov.al/>. Kjo faqe interneti menaxhohet nga Agjencia Kombëtare e Diasporës dhe mirëmbahet nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit.
2. Këshilli Koordinues i Diasporës ka profil zyrtar në media sociale, si: *facebook*, *instagram*, *twitter* dhe *linkedin*, të cilat menaxhohen nga Agjencia Kombëtare e Diasporës.
3. Çdo anëtar i Këshillit Koordinues të Diasporës ka një adresë zyrtare nga *domain-i @diaspora.gov.al*, konkretisht emër.mbiemër@diaspora.gov.al.
4. Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 320, datë 15.05.2019, “Për statusin e anëtarëve të Këshillit Koordinues të Diasporës”, Agjencia Kombëtare e Diasporës i drejtohet Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) me shkresë zyrtare për hapjen e e-maileve zyrtare të anëtarëve të Këshillit Koordinues të Diasporës. Përfaqësuesit në Komitetin e Diasporës dhe përfaqësuesit e çdo ministrie duhet të bëhen publikë bashkë me informacionin e kontaktit.
5. E-mailet zyrtare do të jenë në përdorim të anëtarëve të Këshillit Koordinues të Diasporës vetëm gjatë ushtrimit të detyrës së tyre.



**KËSHILLI KOORDINUES
I DIASPORËS**

6. Mbyllja e e-mailit zyrtar bëhet sipas parashikimeve të nenit 6 të kësaj rregulloreje, me shkresën zyrtare që Agjencia Kombëtare e Diasporës i dërgon AKSHI-t në momentin e mbarimit të mandatit.

Neni 11

Marrëdhënia me institucionet shtetërore

1. Anëtarët e Këshillit Koordinues të Diasporës kanë të drejtë të marrin pjesë në mbledhjet e Komitetit Shtetëror të Diasporës, duke njoftuar nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Diasporës. Agjencia Kombëtare e Diasporës njofton anëtarët e Këshillit Koordinues të Diasporës, të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara datës së zhvillimit të mbledhjes së Komitetit Shtetëror të Diasporës.
2. Anëtarit të Këshillit Koordinues të Diasporës, të interesuar për të ndjekur mbledhjet e Komitetit Shtetëror për Diasporën i vihen në dispozicion jo më pak se 6 (gjashtë) ditë përpara zhvillimit të mbledhjes, materialet sipas rendit të ditës nga sekretariati teknik.
3. Anëtarët e Këshillit Koordinues të Diasporës mund të marrin pjesë në seanca dëgjimore në Komisionet e Kuvendit të Shqipërisë për çështje që kanë të bëjnë me interesat e Diasporës shqiptare, duke respektuar procedurat e përcaktuara në Rregulloren e Kuvendit të Shqipërisë për ndjekjen e seancave dëgjimore në komisionet e tij. Agjencia Kombëtare e Diasporës njofton anëtarët e Këshillit Koordinues të Diasporës, të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara datës së zhvillimit të dëgjësës.

Neni 12

Ndarja e detyrave

1. Anëtarët e Këshillit Koordinues të Diasporës ndajnë midis tyre detyrat për ndjekjen e çështjeve dhe miratojnë ecurinë e tyre për të adresuar problematikat. Përcjellja e problematikave dhe propozimet për zgjidhjen e tyre pranë institucioneve shtetërore zhvillohen në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Diasporës.
2. Secili nga anëtarët e Këshillit Koordinues të Diasporës organizon sipas nevojës takime me shoqata të shqiptarëve në diasporë dhe me komunitetin atje. Takimi zhvillohet në mjediset e ambasadës shqiptare në shtetin pritës ose në mjedise të tjera të përshtatshme. Anëtarët duhet të informojnë Këshillin Koordinues të Diasporës dhe Agjencinë Kombëtare të Diasporës mbi takimet e zhvilluara dhe rezultatet e tyre.
3. Secili nga anëtarët e Këshillit mban kontakte me komunitetet shqiptare.



**KËSHILLI KOORDINUES
I DIASPORËS**

**Neni 13
Grupet e punës**

1. Sipas nevojës, Këshilli Koordinues i Diasporës, mund të krijojë grupe pune për të trajtuar çështje teknike me natyrë ekonomike, ligjore, statusore, kulturore, shkencore e sportive. Numri i anëtarëve dhe mënyra e organizimit dhe funksionimit të grupeve të punës përcaktohet me vendim të Këshillit Koordinues të Diasporës, në zbatim të pikës 3 të nenit 21, të ligjit nr. 16, datë 05.04.2018 “*Për Diasporën*”.
2. Këshilli mund të vendosë krijimin e komisioneve apo komiteteve për zhvillimin dhe përzgjedhjen e projekteve dhe ideve me interes të veçantë dhe strategjik.

**Neni 14
Informimi dhe propozimet administrative**

1. Anëtarët e Këshillit Koordinues të Diasporës kanë të drejtë të kërkojnë informacion përmes dërgimit të kërkesës në mënyrë elektronike dhe shkresore nga institucionet shtetërore të Republikës së Shqipërisë, për çështje që lidhen me interesat e komuniteteve shqiptare të Diasporës. Ajo mund të kryhet edhe me ndërmjetësimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës.
2. Anëtarët e Këshillit Koordinues të Diasporës kanë të drejtë që nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Diasporës të propozojnë, pranë institucioneve shtetërore, akte administrative që lidhen me interesat e komuniteteve shqiptare në Diasporë.

**Neni 15
Kuvendi i Diasporës**

1. Këshilli Koordinues i Diasporës vendos për organizimin e Kuvendit të Diasporës Shqiptare dhe për mënyrën e bashkëpunimit me strukturat përgjegjëse shtetërore.
2. Faqja zyrtare e Kuvendit të Diasporës drejtohet nga Këshilli Koordinues i Diasporës sipas vendimmarrjes së tij. Aspektet teknike mbulohen nga Agjencia Kombëtare e Diasporës në koordinim me AKSHI-n.

**Neni 16
Miratimi dhe ndryshimi i rregullores**

1. Rregullorja e Këshillit Koordinues të Diasporës miratohet nga jo më pak se dy të tretat e anëtarëve të Këshillit Koordinues të Diasporës.
2. Ndryshimi i kësaj Rregulloreje mund të nisë procedurën me kërkesën e një të tretës së anëtarëve ose me kërkesën e kryetarit të tij.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOORDINUES I DIASPORËS

Nr. 600 Prot.

Tiranë, më 18.12.2019

VENDIM

Nr. 2, datë 18.12.2019

PËR

**“ZGJEDHJEN E KRYETARIT, NËNKRYETARIT DHE SEKRETARIT TË KËSHILLIT
KOORDINUES TË DIASPORËS”**

Në mbështetje të nenit 18, pika 2 dhe nenit 21 të Ligjit Nr. 16/2018 “Për diasporën”, të vendimit Nr.340, datë 06.06.2018 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për kushtet dhe mënyrën e zgjedhjes së përfaqësuesve të Këshillit Koordinues të Diasporës”, Vendimit Nr. 195, datë 05. 04. 2019 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e anëtarëve të Këshillit Koordinues të Diasporës” dhe Vendimit Nr.320, datë 15.05.2019 të Këshillit të Ministrave “Për statusin e anëtarëve të Këshillit Koordinues të Diasporës”, Këshilli Koordinues i Diasporës,

VENDOSI:

1. Zgjedhjen si Kryetar të Këshillit Koordinues të Diasporës z. Mark Gjonaj me 32 pikë nga votimi.
2. Zgjedhjen si Nënkyetare të Këshillit Koordinues të Diasporës znj. Anila Hyka Smorgrav me 14 pikë nga votimi.
3. Për zgjedhjen e Sekretarit të Këshillit Koordinues të Diasporës u votuan me 7 pikë z. Ardian Radovicka dhe znj. Adriana Fishta Bejko. Nga vlerësimi i votimeve vihat re se votat për z. Ardian Radovicka janë të gjitha për pozicionin e Sekretarit të Këshillit Koordinues të Diasporës. Z. Radovicka tërhiqet nga pozicioni i Sekretarit të Këshillit Koordinues të Diasporës dhe propozon znj. Adriana Fishta Bejko. Këshilli Koordinues i Diasporës miraton znj. Adriana Fishta Bejko si Sekretare të Këshillit Koordinues të Diasporës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOORDINUES I DIASPORËS

Nr. 601 Prot.

Tiranë, më 18.12.2019

VENDIM

Nr. 3, datë 18.12.2019

PËR

“NGRITJEN E GRUPIT TË PUNËS PËR ORGANIZIMIN E KUVENDIT TË III-TË TË DIASPORËS”

Në mbështetje të nenit 18, pika 2 dhe nenit 21 të Ligjit Nr. 16/2018 “Për diasporën”, të vendimit Nr.340, datë 06.06.2018 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për kushtet dhe mënyrën e zgjedhjes së përfaqësuesve të Këshillit Koordinues të Diasporës”, Vendimit Nr. 195, datë 05. 04. 2019 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e anëtarëve të Këshillit Koordinues të Diasporës” dhe Vendimit Nr.320, datë 15.05.2019 të Këshillit të Ministrave “Për statusin e anëtarëve të Këshillit Koordinues të Diasporës”, Këshilli Koordinues i Diasporës,

VENDOSI:

1. Zëvendësimin e emrit të eventit “Samiti i Diasporës” në “Kuvendi i Diasporës”.
2. Ngritjen e grupit të punës për organizimin e Kuvendit të III-të të Diasporës.
3. Anëtarë të grupit të punës për organizimin e Kuvendit të III-të të Diasporës janë:

- | | |
|-----------------------------|---|
| - Znj. Anila Hyka Smorgrav | Nënkryetare e Këshillit Koordinues të Diasporës |
| - Znj. Adriana Fishta Bejko | Sekretare e Këshillit Koordinues të Diasporës |
| - Z. Visar Tasimi | Anëtar i Këshillit Koordinues të Diasporës |
| - Z. Rosario Petta | Anëtar i Këshillit Koordinues të Diasporës |
| - Z. Sokrat Sinaj | Anëtar i Këshillit Koordinues të Diasporës |
| - Znj. Brikena Muharremi | Anëtare e Këshillit Koordinues të Diasporës |

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLI KOORDINUES I DIASPORËS

Mark	GJONAJ	KRYETAR
Anila	HYKA SMORGRAV	NËNKRYETARE
Adriana	FISHTA BEJKO	SEKRETARE
Ardian	LEKAJ	ANËTAR
Ardian	RADOVICKA	ANËTAR
Bashkim	BEKIRI	ANËTAR
Brikena	MUHARREMI	ANËTAR
Endri	HATILLARI	ANËTAR
Esmeralda	MOSKO	ANËTAR
Gazmend	KAPLLANI	ANËTAR
Lazim	DESTANI	ANËTAR
Namik	SHABI	ANËTAR
Rosario	PETTA	ANËTAR
Sokrat	SINAJ	ANËTAR
Visar	TASIMI	ANËTAR